



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 293/5 prot.

Datë 16.02.2026

V E N D I M
Nr. 260/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro **pa TVSH**, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Vazhdimi i shqyrtimit në themel të pjesës tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit të mësipërme.

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit të mësipërme.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe adresë Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-01-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet e një) Euro **pa TVSH**, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 29.01.2026, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është administruar ankimi elektronik A/2026/6292, protokolluar me nr.293/2026 prot., i operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026, ngarkuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 293/1 prot., datë 06.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, vendim KSHA 16/2026 ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë duke argumentuar se:

II.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Advanced Business Solutions - ABS” shpk mbi modifikimin e Dokumenteve te Tenderit, konkretisht te formes së zgjedhur të prokurimit, duke argumentuar se: “[...]Perdorimi i formës se organizimit “Marreveshje Kuader” nuk është i pershtatshëm the nuk i përgjigjet natyres reale të sherbimit të kërkuar pasi marreveshja kuader, sipas qëllimit dhe funksionit të saj ligjor perdoret për raste kur. sasia, shpeshtesia ose koha e realizimit të shërbimeve nuk mund te percaktohet paraprakisht, shërbimet aktivizohen sipas nevojës përmes kontratave individuale, nuk kërkohet angazhim i pandërprerë dhe i garantuar ne kohe reale... Per me tepër dokumentet e tenderit nuk përmbajnë asnje reference të qarte dhe të

argumentuar ku të detajohet forma e Marrëveshjes kuadër. Në mungesë të këtij arsytimi dhe sqarimi, forma e zgjedhur e prokurimit krijon nje situatë kontradiktore ligjore dhe operacionale, si dhe rrezikon të mosreflektojë në mënyrë korrekte natyrën reale të shërbimit të kërkuar, duke e bërë procedurën potencialisht të papërshtatshme nga pikëpamje e organizimit dhe zbatimit praktik... ”, KSHA arsyeton se:

Në kuptim të legjislacionit të prokurimit publik, marrëveshja kuadër është një marrëveshje ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, me qëllim vendosjen e kushteve për kontratat që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, vecanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara.

Gjithashtu nëpërmjet dispozitave ligjore të prokurimit publik, ligjvënësi ka parashikuar kohëzgjatjen maksimale të një marrëveshjeje kuadër si dhe llojet e saj.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave argumenton se marrëveshja kuadër ndryshon nga prokurimi tradicional në disa aspekte të konkretizuara si më poshtë vijon:

- perspektivë afatgjatë përtej procesit të buxhetit njëvjeçar (2-4 vjet);*
- planifikimi i nevojave në vend të blerjes sa herë që lind nevoja;*
- sasinë mund të vlerësohen me një shkallë saktësie për një periudhë më të gjatë kohore;*

Për sa më lart, marrëveshja kuadër është e përshtatshme për produkte dhe shërbime me natyrë të përsëritur, kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen, dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve dhe të ekzekutimit të kontratave.

KSHA konstaton se në Specifikimet teknike të publikuara në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Autoriteti Kontraktor Përfitues, ka përcaktuar se mirëmbajtja e platformës së integruar të spitalit është një dornosdoshmëri funksionale dhe strategjike, pasi nga operimi i saj i saktë varet drejtpërdrejtë siguria e pacientëve, cilësia e trajtimit dhe kontinuiteti i shërbimeve shëndetësore.

Gjithashtu Spitali Memorial Fier, nëpërmjet Specifikimeve teknike ka argumentuar në mënyrë të qartë dhe koncize se mirëmbajtja e kësaj platforme është një proces kritik që duhet të garantojë funksionimin e sigurtë dhe të pandërprerë të të gjitha proceseve klinike, administrative dhe operative të spitalit (24/7).

Në lidhje me pretendimin e ankimesit se AK nuk ka arsyetuar teknikisht se pse ka zgjedhur këtë formë marrëveshje kuadër, KSHA argumenton se në Specifikimet Teknike të publikuara për procedurën e prokurimit objekt i këtij ankimi, është implementuar i gjithë informacioni i nevojshër në lidhje me proceset teknike që duhet të zbatohen me qëllim mirëmbajtjen e platformës.

Në Spçifikimet teknike janë parashikuar mënyrat e menaxhimit të përdoruesve dhe aksesit; siguria e të dhënave dhe mbrojtja e informacionit; integrimi dhe përshkallëzimi i moduleve i

platformës; monitorimi dhe raportimi; asistenca dhe suporti teknik; kohëzgjatja e këtij shërbimi si dhe përgjegjësitë të cilat janë pasqyruar si më poshtë vijon:[..]

[..] Në mungesë të këtyre proceseve teknike, Autoriteti Kontraktor Përfitues, ka argumentuar se rrezikon rrjedhje të të dhënave, bllokim të sistemit, sulme kibernetike dhe humbje të informacionit mjekësor, situata të cilat do të paralizojnë veprimtarinë e institucionit dhe do të preknin drejtpërdrejtë mijëra pacientë që marrin shërbime pranë Spitalit Memorial.

Për të gjitha arsyet e përmendura më lart, si dhe duke iu referuar natyrës së shërbimit, i cili kërkon vazhdimësi dhe qëndrueshmëri (24/7), KSHA arsyeton se përdorimi i marrëveshjes kuadër është një mënyrë efektive dhe praktike e cila garanton shmangien e zhvillimit të procedurave të përsëritura të prokurimit përgjatë periudhës së parashikuar në njoftimin e kontratës (konkretisht 36 muaj).

KSHA thekson se objekti i procedurës së prokurimit, ka të bëjë me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit për Spitalin Rajonal Memorial Fier, ku qartazi është e nevojshme përdorimi i marrëveshjes kuadër me një Operator ekonomik duke iu përgjigjur në këtë mënyrë natyrës reale të shërbimit spitalor. Ndarja në lote do të cënonte integritetin funksional të sistemit, pasi do të kishte ndikim direkt në funksionimin e moduleve dhe përgjegjësinë teknike. Finalizimi me disa Operatorë ekonomikë do të krijonte problematikë në praktikë pasi:

Identifikimi dhe menaxhimi i incidenteve do të ishte i vështirë dhe i paqartë dhe do të cënonte sigurinë dhe efektivitetin e këtij sistemi;

- Implementimi i këtij shërbimi do të komplikohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës;*
- Do të kishte rritje të kostove në mënyrë të pajustificuar;*
- Duke qenë se platforma përmban një sasi të madhe të dhënash shumë të ndjeshme personale dhe shëndetësore, të cilat kërkojnë mbrojtje sipas standarteve më të larta të sigurisë, cdo cënim i tyre do të kishte pasoja të rënda për pacientët dhe institucionin, si dhe do të vështirësonte kontrollin e cilësisë së shërbimit.*

Në përfundim, KSHA argumenton se forma e përzgjedhur e prokurimit; “Marrëveshje Kuadër me një Operator ekonomik në të gjitha kushtet janë të përcaktuara” është teknikisht dhe ligjrisht e justifikuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi duke marrë në konsideratë objektin e procedurës së prokurimit, (i cili ka të bëjë me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit për Spitalin Rajonal Memorial Fier); natyrës së shërbimit ku sistemi duhet të sigurojë funksionim të pandërprerë 24/7, si dhe duke iu referuar kohëzgjatjes së kontratës të parashikuar në 36 muaj, Marrëveshja Kuadër është një formë ligjorë- teknike, e cila garanton vazhdimësi, qëndrueshmëri dhe efikasitet në kuadër të shërbimit spitalor objekt i këtij ankimimi.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Advanced Business Solutions - ABS” shpk mbi modifikimin e Dokumenteve tii Tenderit , duke argumentuar se: “AK do të vleresoje ofertat e OE në bazë të “Ofertes ekonomikisht me e favorshme, bazuar ne kosto ”, ku çmimi ka 70 pike pervoja/eksperiencat e ngjashme kane 30 pike. Nderkohë qe elementi “çmim ” është i qartë, ne gjykojme se elementi ”pervoje/eksperiencë e ngjashme” është kufizues diskriminues dhe ne disporporcion me natyren e kontratës, pasi OE do te vleresohen në bazë të numrit të moduleve qe kane zbatuar gjatë tre viteve te fundit, duke e lidhur drejtperdrejte pikezimin me sasine e moduleve te realizuara nga secili ofertues...” KSHA arsyeton se:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e tenderit janë formuluar duke përmbajtur dy faza, së pari, fazën e përzgjedhjes ku përfshihen kriteret e vecanta të kualifikimit dhe në përfundim të saj përzgjidhen dhe kualifikohen Operatorët ekonomikë ofertat e të cilëve klasifikohen si të vlefshme dhe së dyti, faza e përrgjedhjes së Operatorit ekonomik, i cili do të shpallet fitues në varësi të raportit çmim-cilësi sipas kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese.

Në këtë kuadër, vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, si çmimi (70 pikë), Përvoja/eksperiencia e ngjashme (30 pikë), sipas dokumentave standarde të tenderit, të hartuara dhe publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, ka implementuar informacionin e nevojshëm në lidhje me kapacitetin teknik e konkretisht me shërbimet e mëparshme të ngjashme ku dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3. 1 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, do të shërbejë që ofertat të kualifikohen, më pas për shpalljen e fituesit do të analizohen modulet e ngjashme të zbatuara në tre vitet e fundit.

Vlerësimi do të realizohet bazuar në modulet që OE ka zbatuar më parë, sa më shumë module aq më shumë pikë merr ofertuesi dhe kështu vazhdon në shkallë zbritëse.

KSHA gjykon se mbështetur në objekt in e prokurimit, i cili ka të bëjë me shërbimin e inirëmbajtjes së platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier, kriteret kualifikuese duhet të jenë në raport dhe në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës objekt prokurimi. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të provojnë dhe të dokumentojnë se kanë aftësitë e nevojshme ekonomiko-tekniko-profesionale në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi, pra në rastin konkret kanë detyrimin që të garantojnë shërbimin e mirëmbajtjes st platformës të sistemit të dixhitalizimit për Spitalin Rajonal Memorial Fier, sipas kushteve të përcaktuara nga AK të implementuara në DST’, si dhe në përputhje me Specifikimet Teknike të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë dhe kritike të shërbimit objekt prokurimi, i cili lidhet ngushtësisht dhe në mënyrë direkte me funksionimin e sistemeve informatike spitalore dhe mbështetjen e proceseve klinike dhe administrative, përvoja paraprake e Operatorëve ekonomikë në mirëmbajtjen e këtyre rmoduleve spitalore përbën një element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të shërbimit. Në këtë kuadër, ky kriter për përzgjedhjen e

operatorëve ekonomikë me oferta ekonomike-ligjore dhe teknike të vlefshme është i arsyeshëm, objektiv dhe i lidhur ngushtësisht dhe drejtpërsëdrejti me objektin e kontratës, duke siguruar realizmin me cilësi dhe në mënyrë të vazhdueshme të shërbimit të kërkuar.

Bazuar në këtë aspekt të vlerësimit teknik dhe përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë ka derivuar edhe përcaktimi i këtij kriteri, klasifikuar si kriter peshe/pikëzimi me një total pikësh prej 30.

Referuar objektit të kontratës që ka të bëjë me mirëmbajtjen si pjesë e një procesi teknik, që siguron stabilitet, performancë të lartë si dhe besueshmëri të sistemit, nënkupton se përfshin monitorim të vazhdueshëm të serverëve, optimizim të bazave të të dhënave, azhurnime sigurie, përmirësime funksionale, testime teknike, dhe zgjidhje të menjëhershme të çdo defekti.

Kjo platformë përfshin 26 module të rëndësishme për regjistrimin e pacientëve, administrimin e historikut mjekësor, menaxhimin e analizave laboratorike, përshkrimin dhe administrimin e terapisë, ndjekjen e lëvizjes së pacientëve ndër shërbime, si dhe komunikimin e brendshëm ndërmjet stafit mjekësor dhe atij mbështetës.

Referuar Specifikimeve teknike, mirëmbajtja e sistemit është një element i rëndësishëm, i cili ka si qëllim:

- *mbrojtjen e pacientëve, duke garantuar që të dhënat e tyre shëndetësore janë të sakta dhe të aksesueshme në çdo moment;*
- *ruajtjen e integritetit të informacionit, duke shmangur deformime, humbje apo komprometim të të dhënave;*
- *sigurimin e vazhdimësisë së proceseve spitalore, që janë të ndërlidhura ngushtë me sistemin dixhital;*
- *rritjen e cilësisë së trajtimit, duke i mundur stafit klinik vendimmarrje të shpejtë dhe të bazuar në të dhëna të sakta;*
- *përbushjen e standardeve të mbrojtjes së të dhënave dhe kërkesave rregullatore të institucioneve shtetërore;*
- *rritjen e sigurisë kibernetike, në një kohë kur institucionet shëndetësore janë ndër objektivat më të shpeshta të sulmeve dixhitale;*
- *funksionimin e pandërprerë të spitalit, i cili varet drejtpërdrejt nga funksionaliteti i platformës.*

Për sa më lart cituar, duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit (i cili ka të bëjë me mirëmbajtjen e platformës të organizuar në 26 module), qëllimin dhe impaktin e këtij shërbimi në mbrojtjen e pacientëve dhe të dhënave personale të tyre, KSHA gjykon se vlerësimi në bazë të numrit të moduleve të zbatuara gjatë tre viteve të fundit është një kërkesë proporcionale; në përputhje me natyrën e kontratës objekt ankimimi.

Ndodhur në kushtet ku kjo platformë e integruar e dixhitalizimit është komponent kritik për operimin e institucionit shëndetësor spitalor, KSHA gjykon se kjo kërkesë shërben për të

vlerësuar aftësinë reale të ofertuesit, i cili nëpërmjet përvojës dhe eksperiencës së mëparshme do të provojë dhe do të dëshmojë:

- *aftësitë e tij në menaxhimin e sistemeve kritike dhe komplekse spitalore që mund të shfaqen gjatë zbatimit të kontratës;*
- *aftësinë e tij për t'iu përgjigjur nevojave të institucionit spitalor ku do të garantojë shërbim të pandërprerë 24/7;*
- *aftësinë e tij për ndërhyrje të specializuara dhe të vazhdueshme sipas fushës profesionale;*
- *aftësinë e tij për të operuar në përputhje ëe standartet e IT'-së në fushën e shëndetësisë; aftësinë e tij për të ofruar një shërbim mirëmbajtje efikas, funksional dhe të sigurtë.*

Në lidhje me pretendimin e OE ankimes se: "...Këto teknologji gjenden rëndom në çdo lloj fushe zbatimi the aplikohen gjerësisht në sisteme bankare, sisteme tatimore, sisteme doganore, sisteme të gjendjes civile, sisteme arsimore, platforma e-government, sisteme ERP/CRM, sisteme kritike 24/7, etj. Në mënyrë absolute asnjë nga këto teknologji nuk kërkon njohuri klinike apo përvojë mjekësore për t'u mirëmbajtur..."

Në Dokumentet Standarte të Tenderit, Njoftimi i Kontratës, Seksioni 4, pika 4.4, Autoriteti Kontraktor, ndër të tjera ka argumentuar se: "Ky vlerësim do të bëhet për shkak in specifikës që sisfemi kv, që ëshië sislem i një spilali. Në specifikimet teknike është argumentuar rëndësia që ky sistem ka në mirëfunksionimin dhe shërbimin e Spitalit Memorial Fier ndaj eksperiencia e ngjashme në module spitalore është mjaft e rëndësishme për të garanfuar sigurinë dhe vazhdimësinë e mirëmbajtjes së sistemit..."

Në Specifikimet Teknike të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, përcaktohet se: Platforma shërben si bërthamë teknologjike që lidh të gjitha strukturat kryesore të spitalit: laboratorin, farmacinë, radiologjinë, angiografinë, kirurgjinë e përgjithshme, mjekësinë interne, bllokun operator, administratën dhe çdo shërbimi klinik e mbështetës. Çdo shërbim klinik e mbështetës. Cdo shërbim komunikon dhe shkëmben të dhëna përmes saj. Për këtë arsye platforma është jo vetëm logjistika dixhitale e spitalit, por edhe elementi që mban të integruar të gjithë zinxhirin e trajtimit të pacientit.

Gjithashtu në Specifikimet teknike janë implementuar të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me: përmbajtjen e platformës; qëllimin dhe funksionalitetin për secilin modul; rrjedhën e punës; teknologjinë që do të përdoret si dhe sigurinë dhe privatësinë e aplikuar.

Mirëmbajtja përfshin monitorim të vazhdueshëm të serverëve, optimizim të bazave të të dhënave, azhurnime sigurie, përmirësime funksionale, testime teknike, dhe zgjidhje të menjëhershme të cdo defekti.

Pa mirëmbajtje të vazhdueshme, rrezikohet cilësia e shërbimit mjekësor, siguria e pacienteve, konfidencialiteti i të dhënave, performanca e stafit dhe aftësia e institucionit për të ofruar

shërbime shëndetësore në mënyrë të sigurtë dhe profesionale. Për këtë arsye, kryerja e mirëmbajtjes së rregullt nuk është një zgjedhje teknike, por një detyrim strategjik për garantimin e jetës, sigurisë dhe integritetit të shërbimeve në Spitalin Memorial.

Duke qenë se platforma permban një sasi të madhe të dhënash shumë të ndjeshme personagle dhe shëndetësore, të cilat përpunohen çdo ditë nga të gjitha shërbimet e spitalit, është e rëndësishme mbrojtja e tyre sipas standardeve më të larta të sigurisë, pasi çdo cenim i tyre do të kishte pasoja të rënda st për pacientët ashtu dhe për institucionin.

Konkretisht c gjithë platforma është e ndërtuar mbi 26 (njëzetü e gjashtë) module, kn nga përmbajtja e Specifikimeve teknike përcaktohet roli dhe qëllimi për secilin modul saktësisht:[...].

Për sa më lart cituar, në lidhje me pretendimin e OE ankimues se teknologjitë nuk kërkojnë njohuri klinike apo përvojë mjekësore për t'u mirëmbajtur, KSHA arsyeton se referuar moduleve të përkufizuara sipas Specifikimeve teknike kërkojnë njohuri të veçanta specifike që u përgjigjen nevojave të shërbimit spitalor.

Pra, ndodhur në kushtet ku sistemet spitalore janë sisteme me funksion të pandërprerë (24/7), të cilat operojnë në procese si: menaxhimi i të dhënave të paeientëve; planifikim i i shërbimeve si dhe raportimet e ndryshme, KSHA gjykon se është e nevojshme që Operatorët ckonomikë pjesmarrës të kenë ekspericncë dhe përvojë të ngjashme në mirëmbajtjen e sistemeve informatike për spitale. Për shkak të natyrës dhe qëllimit të shërbimit, është e nevojshme që Ofertuesit të dëshmojnë se:

- disponojnë njohuritë praktike në lidhje me proceset e brendshme spitalore;
- kanë njohuritë e nevojshme mbi menaxhimin e regjistrave dhe pranimeve të pacientëve;
- kanë njohuri mbi të gjitha aktivitetet e shërbimeve infermierore si dhe të kujdesit ndaj pacientëve gjatë qëndrimit në spital.

[...]KSHA gjykon se kërkesa e AK për vlerësimin e përvojës së ngjashme në bazë të numrit të moduleve të ngjashme që ofertuesi ka zbatuar gjatë eksperiencës së tij në tre vitet e fundit, është ligjore dhe proporcionale me natyrën e shërbimit objekt kontrate. Metoda e vlerësimit është e matshme në raport me modulet e paraqitura nga Ofertuesi, ku sa më shumë module të realizuara gjatë 3 viteve të fundit aq më shumë pikë merr ai.

Eksperienca e ngjashme në module spitalore i korespondon sistemit spitalor ku do të aplikohet kjo platformë, e cila për shkak të natyrës specifike kërkon njohuri të veçanta në këtë fushë me qëllim garantimin e shërbimit me efektivitet; qëndrueshmëri dhe vijimësi.

Theksojmë se mungesa e aksesit në informacion të saktë dhe në kohë reale shkakton vonesa në diagnostikim dhe trajtim, duke ulur efikasitetin e punës dhe dëmtuar cilësinë e shërbimit, është e rëndësishme që sistcmi të sigurojë funksionim të pandërprerë 24/7, në përputhje me natyrën e shërbimeve spitalore. Pra mirëmbajtja e vazhdueshme dhe profesionale e platformës është thelbësore për zbatimin e standarteve më të larta të sigurisë, duke përfshirë enkriptimin, kopjet

rezervë (backup), procedurat e rikuperimit në rast problematikash, si dhe masat e mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike.

Në mungesë të këtyre proceseve, Autoriteti Kontraktor Përfitues, ka argumentuar se rrczikon rrjedhje të të dhënave, bllokim të sistemit, sulme kibernetike dhe humbje të informacionit mjekësor, situata të cilat do të paralizojnë veprimtarinë e institucionit dhe do të preknin drejtpërdrejtë mijëra pacientë që marrin shërbime pranë Spitalit Memorial.

Për arsyet e cituara më lart, KSHA gjykon se kjo kërkesë është në përputhje të plotë me objektin e procedurës së prokurimit, (i cili ka të bëjë me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit për Spitalin Rajonal Memorial Fier), si dhe në harmoni me natyrën e platformës, që do t'i nënshtrohet procesit të mirëmbajtjes (ku referuar Specifikimeve teknike, platforma teknike, përfshin në vetvete 26 module të rëndësishme që kanë të bëjnë me regjistrimin e pacientëve; administrimin e historikut mjekësor; menaxhimin e analizave laboratorike; përshkrimin dhe administrimin e terapisë; ndjekjen e lëvizjes së pacientëve ndër shërbime, si dhe komunikimin e brendshëm ndërmjet stafit mjekësor dhe atij mbështetës).

Fakti që ky kriter është përdorur si element pikëzimi dhe jo si kriter kualifikues, tregon se është ruajtur parimi i proporcionalitetit dhe i konkurrencës, pasi çdo Operator ekonomik që midis të tjerash paraqet module të realizuara në kuadër të shërbimeve të ngjashme mund të ofertojë dhe potencialisht të shpallet i kualifikuar, ndërsa ata që arrijnë të provojnë se kanë realizuar module spitalore si shërbime të ngjashme, do të vlerësohen me pikë më të larta.

Pesha prej 30 pikësh, në një sistem vlerësimi të përbërë prej 100 pikësh, përfaqëson një përqindje të arsyeshme dhe jo diskriminuese. Ajo nuk përjashton Operatorët që nuk i plotësojnë kushtet, por i favorizon ata që vërietojnë se kanë eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit. Ky është thelbi i një kriteri cilësor konkurrues, jo diskriminues, por që nxit ofrimin e shërbimeve më të mira.

Pra, koncepti i modulëve spitalorë është përdorur si një kriter pikëzimi në kuadrin e përzgjedhjes së Operatorit ekonomik fitues lidhur me natyrën e shërbimit si dhe me rëndësinë e tij.

Gjithashtu, parimi i ushtrimit të diskrecionit në vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor për përzgjedhjen e kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese, i nënshtrohet edhe rregullimeve të Nenit 11 "Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit" të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ku përcaktohet se :

"Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme.

- a) është i parashikuar me ligj,
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit,
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi, dhe,

ç) zgjedhja nuk perben nje shmangie të pajustificuar nga vendimet e meparshme të marra nga i njëjti organ ne raste të njëjta apo te ngjashme ”.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e Dokumenteve Standatte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, me arsyetimin se “...Ndarja artificiale e stafit në dy kategoria të ndryshme dokumentimi, ku një pjesë kërkohet të provohet me certifikata të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara, ndërsa pjesa tjetër me diploma ose certifikata kualifikimi sipas Ligjit per Arsimin dhe formimin Profesional, krijon një mospërputhje të qartë logjike, teknike dhe ligjore. Ky dallim nuk mbështetet në asnjë analizë objektive të natyrës së roleve, nuk lidhet me nivelin e përgjegjësisë teknike të secilit pozicion dhe nuk reflekton praktikën reale të tregut të shërbimeve IT...” KSHA gjykon se:

[...]Referuar Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve teknike dhe Krieteve për kualifikim, publikuar në SPE është argumentuar teknkikisht dhe ligjrisht kërkesa në lidhje me personelin e nevojshëm për zbatimin c kontratës.

Duke mbajtur në konsideratë objektin dhe natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen e platformës së integruar dixhitale të Spitalit Rajonal Memorial Fier, AK ka përcaktuar personelin e nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses. KSHA argumenton se në varësi të rolit, funksionit si dhe përgjegjësisë që ka secili punonjës i kërkuar gjatë procesit të mirëmbajtjes AK ka përcaktuar dhe dokumentacionin provues që duhet te paraqitet për secilin punonjës. Për shkak të natyrës së objektit të prokurimit, stafi teknik i kërkuar në DST sipas pikës 2.3.3 duhet të zotërojë njohuri të thella teorike inxhinierike si dhe aftësi praktike operacionale të çertifikuara.

Referuar Procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e Specifikimeve teknike dhe Krieteve për kualifikim, publikuar në SPE është argumentuar teknkikisht dhe ligjrisht kërkesa në lidhje me personelin e nevojshëm për zbatimin c kontratës.

Duke mbajtur në konsideratë objektin dhe natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me mirëmbajtjen e platformës së integruar dixhitale të Spitalit Rajonal Memorial Fier, AK ka përcaktuar personelin e nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses. KSHA argumenton se në varësi të rolit, funksionit si dhe përgjegjësisë që ka secili punonjës i kërkuar gjatë procesit të mirëmbajtjes AK ka përcaktuar dhe dokumentacionin provues që duhet te paraqitet për secilin punonjës. Për shkak të natyrës së objektit të prokurimit, stafi tcknik i kërkuar në DST sipas pikës 2.3.3 duhet të zotërojë njohuri të thella teorike inxhinierike si dhe aftësi praktike operacionale të çertifikuara.

Për punonjësit e rednitur sipas pikës b, c, d, f, g, h, i, j duhet të paraqitet:

•Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme; kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

- Çertifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara.

Për punonjësit renditur sipas pikës a, e, k, l, m, n duhet të paraqitet:

- Kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Cv
- Diplomë ose certifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Shenim, Punonjësit e kërkuar në këto kriter duhet të tregojnë U kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha kualifikime të kërkuara.

Në lidhje me punonjësit e kërkuar sipas pikës b,c,d,f,g,h,i,j, theksojmë se këto pozicione kanë role dhe përgjegjësi për projektim arkitekturor (design), analizë dhe modelim sistemesh (analysis & modeling), zhvillim dhe optimizim algoritmik si dhe vendimarrje teknike afatgjatë. Pra, krahas operimit teknik për këto pozicione kërkohen dhe kompetenca inxhinierike të nivelit konceptual dhe matematikor.

Duke u ndalur në aspektet teknike:

Projektimi kërkon: capacity planning; scalability modeling, fault tolerance, high availability si dhe resource allocation matematikor. Të gjithë këto elementë mbështeten në: teori sistemesh të shpërndara, arkitekturë kompjuterike, analiza komplekse e performancës së sistemeve. Këto aftësi dhe përgjegjësi projektohen dhe zhvillohen tërësisht nëpërmjet arsimit universitar dhe jo nëpërmjet kurseve apo trajnimeve afatshkurtra.

Databaza dhe optimizim performance nënkupton: menaxhimin e databazave, e cila kërkon algjebër relacione, normalizim formal, indekse B-Tree/Hash, analiza e planeve të ekzekutimit, kompleksitet algoritmik.

Këto njohuri janë konceptualisht dije akademike dhe matematikore, të cilat nuk mbulohen në kurse disa mujore, por zhvillohen në projeksione afatgjata, të cilat garantohen nëpërmjet arsimit të lartë.

Zhvillim softëare enterprise (Java/Frontend/BPM) kërkon: struktura të dhënash, algoritme, design patterns, arkitekturë mikroshërbimesh, inxhinieri softëare.

Këto njohuri kaq specifike dhe kaq të detajuara fitohen nëpërmjet disiplinës shkencore të inxhinierisë informatike, dhe jo nëpërmjet trajnimeve apo kurseve të ndryshme.

Pra diploma universitare është një mjet i cili garanton dhe provon njohjen e bazës teorike të standardizuar, siguron aftësi analitike dhe projektimi, redukton riskun e vendimarrjeve të

gabuar arkitekturore, mundëson zgjidhje të qëndrueshme afatgjata. Për arsytet e cituara më lart, për punonjësit e implementuar sipas pikave b,c,d,f,g,h,i j është kërkuar diploma universitare si një kërkesë thelbësore dhe objektivisht e domosdoshme për realizimin e proceseve të punës që kanë të bëjnë me aspektin inxhinierik.

Në dallim nga punonjësit e implementuar sipas pikave b,c,d,f,e,h,iJ ku theksojmë se roli i tyre lidhet konkretisht me projektimin teorik, AK për punonjësit e renditur sipas pikës a,e,k,l,mn ka kërkuar diplomë ose certifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional, pasi roli i tyre ka të bëjë me operimin real të infrastrukturës, konfigurim pajisjesh specifike, mirëmbajtje ditore, menaxhim incidentesh si dhe përdorim platformash konkrete [...].

Të gjitha këto detyra c përgjegjësi kërkojnë aftësi praktike “hands-on” që nënkupton:

Netëork & Virtualization nënkupton: konfigurim i sëtch/router, VLAN/Fireëall, hypervisor, cluster HA kërkon komanda reale troubleshooting praktik, ndërhyrje në kohë reale. Në këtë rast certifikimi garanton përvojë praktike me pajisjet fizike.

Alication Server & BI tools kërkon: deployim aplikacionesh, tuning JVM, konfigurim platformash, përdorim mjete analitike specifike. Këto janë aftësi të lidhura drejtpërdrejt me produkte konkrete të sistemit.

Project Management & IT Services Management kërkon: metodologji standarde (PMI/ITIL) procese SLA, incident/change management. dokumentim operacional.

Pra diplomat profesionale apo certifikimet janë mjete që provojnë kompetencë praktike gjatë punës, verifikojnë aftësi operative reale, garantojnë standardizim sipas industrisë, reduktojnë riskun e gabimeve gjatë operimit. Për arsytet e cituara më lart, për punonjësit e implementuar sipas pikave a,e,k,l,m,n është kërkuar diploma profesionale ose certifikatë kualifikimi si një kërkesë që provon dhe garanton realizimin e proceseve të punës.

Sqarojmë se kombinimi i formimit akademik (themel teorik) dhe certifikimi profesional (aftësi praktike) është teknikisht i domosdoshëm për një sistem spitalor kritik. Kjo qasje siguron cilësi dhe siguri maksimale minimizon riskun operativ, garanton vazhdimësi 24/7, përmbush standardet ndërkombëtare të industrisë, mbron interesin publik dhe të dhënat personale shëndetësore.

Ne lidhje ëe pretendimin e ankimesit se: “...Ne Shqipëri nuk ekzistojne as organe certifikuese të akredituara dhe kurse kualifikimi që funksionojnë sipas ligjit per Arsimin dhe Formimin Profesional të cilat në menyrë të kombinuar apo gjithëpërfshirës të lëshojnë 14 certifikime të tilla siç kërkon në këtë procedurë...” KSHA arsyeton se:

Në Urdhërin Nr. 99, date 25.5.2021 “Per miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”, rezulton se:

[...]Referuar kodit të kualifikimit profesional sa i takon fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit e konkretisht skeletkurrikulave përkatëse për profilet mësimore, të publikuara në faqen ryrtare të internetit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në pikën 11.4. “Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional niveli IV i KSHK”, përcaktohet qartë se pas përfundimit me sukses të arsimit profesional në drejtimin mësimor përkatës të çdo kualifikimi në fushën e TIK, niveli IV i KSHK, nxënësi pajiset me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional.

Për sa më sipër, evidentohet qartë se referuar legjislacionit shqiptar ekzistojnë organe certifikuese të akredituara si dhe kurse kualifikimi që lëshojnë certifikata kualifikimi për punonjësit e kërkuar sipas DST, Kriteret e vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.3.3 çka rnon pretendimin e ankimuesit.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankimues se: “...AK të parashikojë dhe të lejojë shprehimisht pranimin e certifikimeve të lëshuara nga organe certifikuese ose prodhuese ndërkombëtare të njohur të cilët ofrojnë programe trajnimi dhe certifikimi të specializuara për secilin prej fushave teknike të kërkuara, duke i konsideruar këto certifikime si ekuivalente dhe të vlefshme për provimin e kapaciteteve profesionale të stafit, në përputhje me praktikën e pranuar ndërkombëtare dhe parimet të konkurrencës së ndershme të prokurimit publik..”, KSHA arsyeton se

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe operimin e një infrastrukture kritike spitalore, në kërkesa të larta sigurie, disponueshmërie dhe performance, argumentojmë se me qëllim nxitjen e pjesmarrjes si operatorëve ekonomik si dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës, krahas Diplomës/Çertifikatës kualifikimit lëshuar në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional, AK të lejojë në formë alternative edhe paraqitjen e Certifikatave të kualifikimit të lëshuara nga subjekte të huaja profesionale certifikues të njohur në industrinë e teknologjisë së informacionit (të vlefshme).

Kjo kërkesë është gjithëpërfshirëse dhe garanton që kualifikimet të bazohen në standarde të verifikueshme, objektive dhe të pranuar ndërkombëtarisht, të cilat përfshijnë testim të pavarur dhe vlerësim praktik të aftësive operacionale (“hands-on”), në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë ndërkombëtare (best practices). certifikatat e lëshuara nga subjekte të huaja profesionale certifikuese të njohura në industrinë e teknologjisë së informacionit, sigurojnë besueshmëri teknike, reduktim të riskut operacionel, duke shmangur trajnime apo dëshmi joformale që nuk garantojnë kompetencë reale profesionale.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

l. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” shpk [...].

II.5. Me anë të shkresës me nr. 283/8 prot., datë 05.02.2026, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 293/2 prot., datë 09.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, vendim KSHA 16/2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Me anë të shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026, ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Ankesave Elektronike, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 293/1 prot., datë 06.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, vendim KSHA 16/2026 ku konstatohet se e ka pranuar pjesërisht atë duke argumentuar në lidhje me pretendimin e pranuar si më poshtë vijon:

[...]

Ne lidhje me pretendimin e OE ankimues se: "...AK te parashikojë dhe te lejojë shprehimisht pranimin e certifikimeve të lëshuara nga organe certifikuese ose prodhuese ndërkombëtare te njohur Ie cilët ofrojnë programe trajnimi dhe certifikimi te specializuara per secilen prej fushave teknike Ie kërkuara, duke i konsideruar keto certifikime si ekuivalente dhe të vlefshme per provimin e kapaciteteve profesionale të stafit, në përputhje me praktikat e pranuar ndërkombëtare dhe parimit të konkurrencës së ndershme të prokurimit publik.. ", KSHA arsyeton se

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe operimin e një infrastrukture kritike spitalore, ne kërkesa të larta sigurie, disponueshmërie dhe performance, argumentojmë se me qëllim nxitjen e pjesmarrjes si operatorëve ekonomik si dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës, krahas Diplomës/Çertifikatës kualifikimit lëshuar në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional, AK të lejojë në formë alternative edhe paraqitjen e Çertifikatave të kualifikimit të lëshuara nga subjekte të huaja profesional certifikues të njohur në industrinë e teknologjisë së informacionit (të vlefshme).

Kjo kërkesë është gjithëpërfshirëse dhe garanton që kualifikimet të bazohen ne standarde të verifikueshme, objektive dhe të pranuar ndërkombëtarisht, të cilat përfshijnë testim të pavarur dhe vlerësim praktik të aftësive operacionale ("hands-on"), në përputhje me praktikat më të mira të industrisë ndërkombëtare (best practices). certifikatat e lëshuara nga subjekte të huaja profesionale certifikuese të njohura në industrinë e teknologjisë së informacionit, sigurojnë besueshmëri teknike, reduktim të riskut operacionel, duke shmangur trajnime apo dëshmi joformale që nuk garantojnë kompetencë reale profesionale.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve

ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, për kundërshtimin e dokumentave të tenderit, nga verifikimi i shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026, dorëzuar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 293/1 prot., datë 06.02.2026, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 293/2026 prot., datë 29.01.2026 të operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për kundërshtimin e dokumentave të tenderit me pretendimin se: “ [...] Nga analiza e dokumentacionit të procedurës së prokurimit, në mënyrë të përmbledhur por thelbësore, rezultojnë se Autoriteti Kontraktor synon të prokurojë një shërbim të pandërprerë (24/7), me karakter të vazhdueshëm dhe të përhershëm, për një periudhë 36-mujore, çka dëshmon qartë se shërbimi objekt prokurimi lidhet drejtperdrejt me procese funksionale të një rendësie të lartë dhe të klasifikuara si kritike për veprimtarinë e institucionit. Në argumentimin e tij Autoriteti

Kontraktor shpjegon se nje sherbim i tille, per nga natyra e tij, nuk eshte sporadik, i rastesishem apo i varur nga nevoja te papercaktuara ne kohe, por perkundrazi perben nje angazhim te vazhdueshem operacional, qe kerkon: - disponueshmeri te garantuar 24/7, - kapacitete teknike dhe njerezore te dedikuara, - nivele te qarta sherbimi, - pergjegjesi te plota kontraktuale dhe - vazhdimesi te panderprere gjate gjithe periudhes 36-mujore. Ne kete kendveshtrim, nga ana jone vleresohet se perdorimi i formes se organizimit "Marreveshje Kuader" nuk eshte i pershtatshem dhe nuk i pergjigjet natyres reale te sherbimit te kerkuar, pasi marreveshja kuader, sipas qellimit dhe funksionit te saj ligjor, perdoret per raste kur: - sasia, shpeshesia ose koha e realizimit te sherbimeve nuk mund te percaktohet paraprakisht; - sherbimet aktivizohen sipas nevojës permes kontratave individuale; - nuk kerkohet angazhim i panderprere dhe i garantuar ne kohe reale. Nderkohe, ne rastin konkret, vete dokumentet e tenderit parashikojne nje sherbim te vazhdueshem, te perhershem dhe te panderprere per 36 muaj, Áka e ben kete sherbim te krahasueshem ne thelb me nje kontrate sherbimi me kohezgjatje te percaktuar, dhe jo me nje marreveshje kuader qe supozon fleksibilitet dhe aktivizim sipas nevojës. Per me teper, dokumentet e tenderit nuk permbajne asnje reference te qarte dhe te argumentuar qe te detajoje: - menyren e aktivizimit te kontratave individuale brenda marreveshjes kuader; - nese dhe kur mund te mos aktivizohet sherbimi; - se si garantohet realisht vazhdimesia 24/7 ne mungese te nje kontrate sherbimi te drejtperdrejte; - apo arsyetimin ligjor dhe teknik pse eshte zgjedhur forma e marreveshjes kuader per nje sherbim qe, sipas vete kerkesave te Autoritetit Kontraktor, duhet te ofrohet pa nderprerje per gjithe periudhen 36-mujore. Ne mungese te ketij arsytimi dhe sqarimi, forma e zgjedhur e prokurimit krijon nje situate kontradiktore ligjore dhe operationale, si dhe rrezikon te mos reflektojne ne menyre korrekte natyren reale te sherbimit te kerkuar, duke e bere proceduren potencialisht te papershtatshme nga pikepamja e organizimit dhe zbatimit praktik. Edhe nga pikepamja e ofertes ekonomike prania e nje Marreveshjeje Kuader me nje operator ekonomik, e cila nga vete natyra e saj presupozon ofrimin e sherbimeve vetem sipas nevojës dhe aktivizimit nga Autoriteti Kontraktor gjate afatit 36-mujor, paraqet nje mosperputhje te qarte dhe kontradiktore me kerkesen e parashikuar ne dokumentet e tenderit per ofrimin e nje sherbimi te panderprere (24/7) per te gjithe periudhen 36-mujore te kontrates. Kjo situate krijon konfuzion te konsiderueshem ne menyren e perlllogaritjes se kostove ekonomike nga operatorët ekonomike, duke cenuar drejtperdrejt parimin e transparences dhe te barazise se trajtimit. Ne kushtet e nje Marreveshjeje Kuader, ku sherbimet ofrohen vetem sipas nevojës se Autoritetit Kontraktor dhe pa nje angazhim te panderprere, operatorët ekonomike aplikojne ne menyre te natyrshme struktura kostosh te ndryshme, zakonisht me te uleta, krahasuar me ato qe kerkohen per garantimin e nje sherbimi te vazhdueshem 24/7/36, i cili presupozon staf te dedikuar, organizim te perhershem operacional dhe kapacitete te rezervuara gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates. Si rrjedhoje, kjo mosperputhje ndermjet formes se procedures dhe natyres reale te sherbimit te kerkuar cenon parimet themelore te prokurimit publik, veÁanerisht parimin e proporcionalitetit, pasi mjeti i zgjedhur nuk eshte ne perpjesetim me objektin e kontrates, si dhe parimin e transparences dhe konkurrences se ndershme, duke mos garantuar kushte te barabarta

dhe te qarta per pergatitjen e ofertave ekonomike te krahasueshme. **KERKESE 1 1.1** Ne zbatim te gërmes “b”, pika 2, Neni 2 i VKM “Per rregullat e prokurimit publik” Autoriteti Kontraktor te argumentoje arsyet e perzgjedhjes se kesaj procedure duke identifikuar qarte nevojat apo pritshmerite e tij per ofrimin e ketij sherbimi. 1.2 AK te argumentoje ne menyre te qarte dhe te detajuar modelin ekonomik te sherbimit qe synohet te prokurohet, duke specifikuar nese: - sherbimi do te jete i garantuar dhe i disponueshem ne menyre te panderprere (24/7) gjate gjithë periudhes 36-mujore, pavaresisht aktivizimit; apo - sherbimi do te aktivizohet vetem sipas nevojës, permes kerkesave te veçanta, ne kuader te Marreveshjes Kuader. 1.3 Autoriteti Kontraktor te argumentoje nese struktura aktuale e procedures krijon rrezik qe operatore ekonomike te ofrojne çmime artificialisht te uleta, bazuar ne supozimin e nje perdorimi minimal te sherbimit, nderkohe qe kerkesat teknike presupozojne kapacitete te rezervuara dhe staf te perhershem”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para këkesës për sqarime për procedurën e mësipërme të prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor apo kërkesa në thelb për ndryshimin e kritereve të veçanta të kualifikimit apo specifikimeve teknike, por në thelb janë paqartësi mbi hartimin e dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, KPP-ja konstaton, se referuar shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026 me të cilën autoriteti kontraktor ka dorëzuar vendim KSHA 16/2026 autoriteti kontraktor, ne kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”, për një pjesë të argumenteve ka dhënë sqarime mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për paqartësitë e tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues në mënyrë të argumentuar dhe shteruese lidhur me paqartësitë e parashtruara në ankesë si më sipërcituar, si dhe këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit me arsyetimin se: “[...] nderkohe qe elementi “cmim” eshte i qarte, ne gjykojme se elementi “pervoje/eksperience e ngjashme” eshte kufizues, diskriminues dhe ne disporpocion me natyren e kontrates. Konkretisht, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar qe: - Pervoja e ngjashme vleresohet ne baze te numrit te moduleve te ngjashme spitalore qe ofertuesi ka zbatuar ne 3 vitet e fundit; - Sistemi objekt mirembajtjeje perbehet nga 26 module; - Sa me shume module te kete zbatuar OE ? aq me shume pike; - Nese OE nuk ka zbatuar asnje modul ? 0 pike. Ne gjykojme se ky proces vleresimi ne menyre te drejteperdrejte percakton ne menyre preferenciale dhe ne kundershtrim me parimet e prokurimit publik nje proces vleresimi te orientuar vetem drejt: (i) moduleve te ngjashme te sherbimit spitalor; dhe (ii) (ii) numrit 26 te moduleve ekzistuese qe jane per tu mirembajtur. Ky qendrim bie ndesh me deklaratat e AK ne Procesverbalin e Argumentimit sipas te cilit “Kjo metode vleresimi nxit konkurrence cilesore, shmang praktikat e ofertave jo reale, pasi siguron AK se ofertuesit sigurojne besueshmerine e organizimit te sherbimit duke dhene nje zgjidhje teknike sa me efektive, sigurojne nivelin e ekspertizes dhe paraqesin kosto reale te justifikuar per kryerjen e sherbimit sipas specifikimeve teknike”. Per kete ceshtje eshte lehtesisht e verifikueshme se grupi i punes per hartimin e ketyre dokumenteve nuk ka marre ne konsiderate percaktimet e Nenit 78, te VKM “Per rregullat e PP”, i cili e ngarkon ate nder te tjera edhe me detyrimin per argumentimin e kerkesave per kualifikim apo vleresim [...]

[...] 2.1 Autoriteti Kontraktor te jape argumente teknike (jo narrative) ne lidhje me kriterin e vleresimit “Pervoja/eksperienca te ngjashme” në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme. 2.2 Ne pamundesi te argumentimit teknik, Autoriteti Kontraktor te heqe kriterin e vleresimit “pervoja/eksperienca te ngjashme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit, si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

- Çmimi 70 pikë
- Përvojë/eksperiencë e ngjashme 30 pikë

Argumentimi i kritereve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

1. Çmimi: 70 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Përvojë/eksperiencë e ngjashme 30 pikë

Argumentimi: Duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë dhe kritike të shërbimit objekt prokurimi, i cili lidhet drejtpërdrejtë me funksionimin e sistemeve informatike spitalore dhe mbështetjen e proceseve klinike dhe administrative, përvoja paraprake e operatorëve ekonomikë në mirëmbajtjen e këtyre moduleve spitalore përbën një element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të shërbimit. Sistemet spitalore janë sisteme me funksion të pandërprerë (24/7), të cilat mbështesin procese menaxhimi të të dhënave të pacientëve, planifikim shërbimesh dhe raportim. Si pasojë cdo ndërprerje ose keqfunksionim ndikon në ofrimin e shërbimit spitalor dhe sigurinë e pacientëve.

Operatorët ekonomikë që kanë eksperiencë në sisteme informatike për spitale disponojnë njohuri praktike mbi arkitekturën e tyre, proceset e brendshme spitalore si dhe flukset e informacionit apo kërkesat për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave. Gjithashtu ka ndikim pasi ul ndjeshëm kohën e tranzicionit duke minimizuar rrezikun dhe fazën e përshtatjes me mjedisin si dhe rrit cilësinë e vendimarrjes teknike.

Ky kriter shërben për të vlerësuar aftësinë reale të ofertuesit për të menaxhuar sisteme komplekse dhe kritike, duke reduktuar rrezikun operacional për autoritetin kontraktor.

Dokumentacioni që do të dorëzohet:

- Dokumentacioni i kërkuar në pikën 2.3.1 të Kritereve të Veçanta për Kualifikim, do të shërbejë që ofertat të kualifikohen, më pas për shpalljen e fituesit do të analizohen modulet e

ngjashme. Për këtë arsye OE do të paraqesin dokumentacion që vërteton zbatimin e moduleve të kontratave/përvojës së ngjashme në tre vitet e fundit.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- **Përvoja/eksperienca e ngjashme** do të vlerësohet bazuar në modulet e ngjashme që ofertuesi ka zbatuar gjatë eksperiencës së tij në tre vitet e fundit. Sipas specifikimeve teknike kërkohet të mirëmbahen 26 (njëzet e gjashtë) module. Vlerësimi do të realizohet bazuar në modulet që OE ka zbatuar, sa më shumë module aq më shumë pikë merr ofertuesi dhe kështu vazhdon në shkallë zbritëse. Nëse ofertuesi nuk ka zbatuar asnjë modul në tre vitet e fundit do të vlerësohet me 0 pikë.

Ky vlerësim do të bëhet për shkak të specifikës që sistemi ka, që është sistem i një spitali. Në specifikimet teknike është argumentuar rëndësia që ky sistem ka në mirëfunksionimin dhe shërbimin e Spitalit Memorial Fier ndaj eksperiencës së ngjashme në module spitalore është mjaft e rëndësishme për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e mirëmbajtjes së sistemit.

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

OSE

B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të vlerësuar).

III.3.2. Në shtojcën nr. 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi, ku ndër të tjera ka përcaktuar si më poshtë:

1. PËRSHKRIMI I PLATFORMES SE INTEGRUAR DHE TE SHKALLEZUESHME TE SISTEMIT TE DIXHITALIZIMIT

Përmbajtja e platformës:

1. *Moduli i Integruar i Sistemit të Menaxhimit të Regjistrave dhe të Pranimeve të Pacientëve në Spitalin Memorial - (Patient Record / Admission Management System)*
2. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Poliklinikës*
3. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Shërbimeve dhe Infermierisë*
4. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Urgjencës (Triage)*
5. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Laboratorit*
6. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Laboratorit Mikrobiologjik*
7. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Radiologjisë*
8. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Sallës Operative*
9. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Farmacisë*
10. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Dietës (Ushqimit të Pacientëve)*
11. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Patologjisë*
12. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Ekranëve të Informacionit (Display LCD)*
13. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Bankës së Gjakut*
14. *Moduli i integruar i Sistemit të Informacionit dhe Raportimit Statistikor*
15. *Moduli i integruar i Menaxhimit*
16. *Moduli i integruar i Menaxhimit Financiar (Faturim, Arka, Pagesa)*
17. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave*
18. *Moduli i integruar i Kontrollit të hyrje - daljeve të stafit*
19. *Moduli i integruar Kiosk Management System*
20. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Mesazheve SMS*
21. *Moduli i integruar i Menaxhimit Teknik dhe të Shërbimeve Mbështetëse*
22. *Moduli i integruar i Menaxhimit të Shërbimeve Mjekësore në Terren (Mobile Doctor)*
23. *Moduli i integruar i menaxhimit të ekzaminimeve online (videocall)*
24. *Modeli i integruar pacs (sistemi i arkivimit dhe komunikimit të imazheve)*
25. *Portali i pacientëve*
26. *Moduli i integruar i menaxhimit të transferimit të imazheve*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.3.4. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

II.3.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj”.*

III.3.6. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënie e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në: a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës”.

III.3.7. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date; b) elementet

fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehur në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si

dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$ P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar $P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomkisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomkisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomkisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = X + Y Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8) Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2) a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme: i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit; ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar; iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar. Nënkriteret e kriterëve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet. b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme: P_e - Pikët për propozimin ekonomik Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët) $P_e = 100 \times \text{Çu} / \text{Ç}$ (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).

III.3.8. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomkisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të koston. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomkisht më të favorshme në bazë të koston, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori

kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese (të vlerësimit). Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Pra, Komisioni gjykon se një prej dallimeve esenciale ndërmjet kriterëve të kualifikimit me kriteret për shpalljen e kontratës fituese është se kriteret e kualifikimit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi në të kundërt oferta e tyre refuzohet, ndërsa kriteret për shpalljen e kontratës fituese kanë karakter vlerësues për të evidentuar ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi dhe nuk përbëjnë shkak për kualifikimin/skualifikimin e ofertave. Gjithsesi, bazuar në nenin 87 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni gjykon se, pavarësisht se kriteret për shpalljen e kontratës fituese janë me karakter të ndryshëm vlerësimi nga kriteret e kualifikimit, parimi për hartimin e tyre është i njëjtë. Pra, për hartimin e të dy kategorive të kriterëve, autoritetet kontraktore duhet të kujdesen që këto kriteret të jenë në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës që prokurohet, të jenë të qarta, të sakta, të mos krijojnë konfuzion, si dhe të garantojnë një konkurrencë efektive duke shmangur çdo lloj kufizimi të panevojshëm. Gjithashtu KPP thekson se në rregullat e prokurimit publik, është përcaktuar qartësisht se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një formulë të qartë mbi mënyrën e përlllogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Inter Allia dhe Mutatis Mutandis në Çështjen nr. Case 6/15- “TNS Dimarso NV v Vlaams Gevest” të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, paragrafi 20, GJED, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“[Omississ... Duhet të theksohet se aty ku autoriteti kontraktor vendos dhënie të një kontrate referuar ofertës ekonomike më të favorshme, sipas nenit 53 (2) të Direktivës 2004/18, ai duhet të specifikojë në njoftimin e kontratës ose specifikimin e tenderit peshën relative të peshimit të tij secilit prej kriterëve të përzgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme. Peshimi mund të shprehet duke parashikuar një hapësirë mes maksimumit të shpërndarjes. Kur, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, peshimi nuk është i mundur për t'u demonstruar arsyet, autoriteti kontraktues do të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose specifikimet e tenderit ose, në rastin e*

një dialogu konkurrues, në dokumentin përshkrues, kriteret në rend zbritës bazuar në rëndësinë]”.

III.3.9. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese të përcaktuara në Seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe konkretisht për kriteret e përcaktimit të ofertës fituese ka përcaktuar si metodologji për përcaktimin e ofertës fituese metodën “Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, duke përcaktuar kriteret të përzgjedhjes së ofertës fituese dhe konkretisht, si në vijim: “1- Çmimi me 70 pikë; Përvojë/eksperiencë e ngjashme 30 pikë”. Duke ju referuar argumentimeve në dokumentat standarte të tenderit të secilit prej kriterëve të sipërcituar Komisioni konstaton, se për kriterin “Çmimi” autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë metodologjinë e vlerësimit me pikë të këtij kriteri, pasi ka publikuar formulën përkatëse për përlogaritjen e pikëve për secilën ofertë ekonomike që do të dorëzohet në këtë procedurë prokurimi, sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndërsa kriterin e përvojës/eksperiencës së ngjashme ka përcaktuar konkretisht: **“Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:Përvoja/eksperiencia e ngjashme do të vlerësohet bazuar në modulet e ngjashme që ofertuesi ka zbatuar gjatë eksperiencës së tij në tre vitet e fundit. Sipas specifikimeve teknike kërkohet të mirëmbahen 26 (njëzet e gjashtë) module. Vlerësimi do të realizohet bazuar në modulet që OE ka zbatuar, sa më shumë module aq më shumë pikë merr ofertuesi dhe kështu vazhdon në shkallë zbritëse. Nëse ofertuesi nuk ka zbatuar asnjë modul në tre vitet e fundit do të vlerësohet me 0 pikë.**

Ky vlerësim do të bëhet për shkak të specifikës që sistemi ka, që është sistem i një spitali. Në specifikimet teknike është argumentuar rëndësia që ky sistem ka në mirëfunksionimin dhe shërbimin e Spitalit Memorial Fier ndaj eksperiencës e ngjashme në module spitalore është mjaft e rëndësishme për të garantuar sigurinë dhe vazhdimësinë e mirëmbajtjes së sistemit”, si dhe ka përcaktuar formulën që do të zbatohet për vlerësimin e këtij kriteri, duke përcaktuar si vlerësim maksimal 30 pikë dhe si vlerësim minimal 0 pikë.

III.3.10. Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor për kriterin “Përvojë/eksperiencë e ngjashme”, Komisioni konstaton, se vlerësimi me pikë për këtë kriter do të bëhet duke analizuar modulet e ngjashme që ka zbatuar ofertuesi gjatë 3 viteve të fundit, pasi sipas specifikimeve teknike kërkohen që të mirëmbahen 26 (njëzet e gjashtë) module. Vlerësimi do të bëhet duke u bazuar në modulet që ka realizuar ofertuesi, ku ofertuesi që ka realizuar më shumë module do të marrë më shumë pikë duke vazhduar në shkallë zbritëse, dhe ofertuesi që nuk ka realizuar asnjë modul do të marrë 0 pikë.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga përcaktimet e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se enti prokurues për këtë kriter ka përcaktuar formulën se si do të realizohet ky vlerësim, sikurse përcaktohet në pikës 7 të nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës

fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në seksionin 4 “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të dokumenteve të tenderit për kriterin “**Përvoja/eksperienca e ngjashme**” jo vetëm mënyrën e llogaritjes me pikë në mënyrë të detajuar, informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit për kriterin e përvojës së ngjashme, që do të merret parasysh dhe metodologjinë që do të aplikohet për këtë kriter, dokumentacionin që do duhet të paraqesë çdo ofertues, por edhe formulën përkatëse të përlllogaritjes së pikëve për këtë kriter, sikurse përcaktohet në pikën 7 të nenit 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në mënyrë që të ketë një vlerësim sa më të drejtë, në mënyrë krahasimore me dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë pjsëmarrës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit me arsyetimin se: “[...] *KERKESE 3 3.1 Autoriteti Kontraktor te paraqese nje argumentim te qarte, te plote dhe te arsyetuar ligjerisht dhe teknikisht mbi arsyet perse kriteret e kualifikimit te stafit jane parashikuar te permbushen permes dy formave te ndryshme dokumentimi dhe certifikimi, duke vendosur bazen ligjore, logjiken teknike dhe proporcionalitetin e kesaj ndarjeje, si dhe lidhjen e saj me natyren e sherbimit objekt prokurimi. 3.2 Autoriteti Kontraktor te identifikojne ne menyre te faktuar dhe te verifikueshme nese kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit reflektojne realitetin aktual te tregut te sherbimeve IT ne Republiken e Shqiperise, veçanerisht ne lidhje me: - ekzistencen e organeve certifikuese te akredituara ne territorin e vendit qe leshojne certifikime per fushat teknike te kerkuara; dhe/ose - ekzistencen e kurseve apo programeve te arsimit dhe formimit profesional qe, ne menyre reale dhe te krahasueshme, ofrojne kualifikime per rolet dhe certifikimet e listuara ne kete procedure. 3.3 Autoriteti Kontraktor te parashikojne dhe te lejoje shprehimisht pranimin e certifikimeve te leshuara nga organe certifikuese ose prodhues nderkombetare te njohur, te cilet ofrojne programe trajnimi dhe certifikimi te specializuara per secilen prej fushave teknike te kerkuara, duke i konsideruar keto certifikime si ekuivalente dhe te vlefshme per provimin e kapaciteteve profesionale te stafit, ne perputhje me praktikat e pranuar nderkombetare dhe parimet e konkurrences se ndershme ne prokurimin publik. 3.4 AK te unifikojne kerkesat per formimin arsimor per te gjithë stafin e specializuar te parashikuar ne piken 2.3.3 ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit. E thene me thjesht, ose te gjithë me Diplome Universitare ose te gjithë me Diplome apo kurse kualifikimi*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se lidhur me pretendimin për pranimin e certifikatave të leshuara nga organe certifikuese ose prodhues ndërkombetare të njohur, referuar shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026, vendimit KSHA 16/2026, rezulton

se ky pretendim është pranuar nga autoriteti kontraktor dhe rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit ka mbyllur çështjen sipas arsytimit në pikën III.1.5 të këtij vendimi.

III.4.1 Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues me arsyetimin se: *“3.1 Autoriteti Kontraktor te paraqese nje argumentim te qarte, te plote dhe te arsyetuar ligjerisht dhe teknikisht mbi arsyet perse kriteret e kualifikimit te stafit jane parashikuar te permbushen permes dy formave te ndryshme dokumentimi dhe certifikimi, duke vendosur bazen ligjore, logjiken teknike dhe proporcionalitetin e kesaj ndarjeje, si dhe lidhjen e saj me natyren e sherbimit objekt prokurimi. 3.2 Autoriteti Kontraktor te identifikojne ne menyre te faktuar dhe te verifikueshme nese kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit reflektojne realitetin aktual te tregut te sherbimeve IT ne Republiken e Shqiperise [...]”*, Komisioni gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërkesës për sqarime për procedurën e mësipërme të prokurimit. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor apo kërkesa në thelb për ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit apo specifikimeve teknike, por në thelb janë paqartësi mbi hartimin e dokumenteve të tenderit. Referuar procesverbalit “Për arumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, Komisioni konstaton, se njësia e prokurimit nuk ka argumentuar teknikisht nevojën për paraqitjen e certifikatave apo diplomave lidhur me stafin e kërkuar. Nga ana tjetër referuar shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026, vendimit KSHA 16/2026, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor, ne kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka dhënë sqarime mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për paqartësitë e tij në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të percaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”*. Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të publikojë sqarimet e dhëna në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, në mënyrë që të bëhen të njohura për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4.2 Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues si vijon: *“AK te unifikojne kerkesat per formimin arsimor per te gjithe stafin e specializuar te parashikuar ne piken 2.3.3 ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit. E thene me thjesht, ose te gjithe me Diplome Universitare ose te gjithe me Diplome apo kurse kualifikimi”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.2.1 Në shtojcën nr. 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në pikën 2.3.3 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për realizimin e shërbimit, minimalisht si më poshtë:*

- a) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ÇNA ose ekuivalent për netëork.*
- b) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për server ne nivelin arkitekt ose ekuivalent.*
- c) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për storage ne nivel arkitekt ose ekuivalent.*
- d) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator sistemi për Sistemet Operative Microsoft Windows Server, Linux ose Unix, ose ekuivalente.*
- e) *Të paktën 1 specialist të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter nivel profesional ose ekuivalent. Te provuar me certifikatat përkatëse të lëshuara nga prodhuesi VMëare ose ekuivalent.*
- f) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për baza të dhenash relacionale te tipit SQL ose ekuivalent.*
- g) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për optimizim te performances te bazes se te dhenave relacionale ose ekuivalent.*
- h) *Të paktën 1 (nje) punonjes të certifikuar për programim në ëeb në teknologji Java enterprise ose ekuivalente.*
- i) *Të paktën 1 (nje) punonjes të certifikuar për menaxhimin e proceseve te punes (business process management) ose ekuivalent.*
- j) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje të ndërfaqeve përdoruesi (Frontend Web Development) ose ekuivalent.*
- k) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për implementim Server Aplikimesh (Application Server) ose ekuivalent.*
- l) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për softëare për analizë të dhënash BI (Business Intelligence) ose ekuivalent.*
- m) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve (PMP ose ekuivalente).*
- n) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).*

Për punonjësit në pikën b,c,d,f,g,h,i,j duhet të paraqitet:

- *Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme; kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.*
- *Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara.*

Për punonjësit në pikën a,e,k,l,m,n duhet të paraqitet:

- *kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.*
- *Cv*
- *Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.*

Shënim: *Punonjësit e kërkuar në këtë kriter në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha/kualifikime të kërkuara.*

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.4.2.2 Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, autoriteti kontraktor ka argumentuar si vijon:

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të ketë stafin e nevojshëm për realizimin e shërbimit, minimalisht si më poshtë:*

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ÇNA ose ekuivalent për netëork.*
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për server ne nivelin arkitekt ose ekuivalent.*
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për storage ne nivel arkitekt ose ekuivalent.*
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator sistemi për Sistemet Operative Microsoft Ëindoës Server, Linux ose Unix, ose ekuivalente.*
- e) Të paktën 1 specialist të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter nivel profesional ose ekuivalent. Te provuar me certifikatat përkatëse të lëshuara nga prodhuesi VMëare ose ekuivalent.*
- f) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për baza të dhenash relacionale te tipit SQL ose ekuivalent.*
- g) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për optimizim te performances te bazes se te dhenave relacionale ose ekuivalent.*

- h) Të paktën 1 (nje) punonjes të certifikuar për programim në ëeb në teknologji Java enterprise ose ekuivalente.
- i) Të paktën 1 (nje) punonjes të certifikuar për menaxhimin e proceseve te punes (business process management) ose ekuivalent.
- j) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje të ndërfaqeve përdoruesi (Frontend Eëb Development) ose ekuivalent.
- k) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për implementim Server Aplikimesh (Application Server) ose ekuivalent.
- l) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për softëare për analizë të dhënash BI (Business Intelligence) ose ekuivalent.
- m) Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar për menaxhimin e projekteve (PMP ose ekuivalente).
- n) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Për punonjësit në pikën b,c,d,f,g,h,i,j duhet të paraqitet:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme; kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuara nga organe çertifikuese të akredituara.

Për punonjësit në pikën a,e,k,l,m,n duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Cv
- Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Shënim: Punonjësit e kërkuar në këtë kriter në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha/kualifikime të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ a), b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është thelbësor për realizimin e kontratës me sukses, duke pasur parasysh specifikat teknike dhe natyrën e shërbimit. Ky kriter është bazuar në analizën e specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga Autoriteti Kontraktor

Punonjësi i certifikuar ÇNA ose me një kualifikim ekuivalent në rrjetë (netëork) është i domosdoshëm pasi siguron funksionimin e qëndrueshëm të rrjetit ku operon sistemi. Ai konfiguron pajisjet e rrjetit, monitoron trafikun dhe parandalon ndërprerjet e shërbimit. Rrjeti është kritik për komunikimin mes serverëve, përdoruesve dhe moduleve të sistemit. Certifikimi ÇNA garanton aftësi praktike për menaxhimin profesional të infrastrukturës së rrjetit.

Punonjësi i certifikuar për server ne nivelin arkitekt ose ekuivalent, është i rëndësishëm pasi ky rol është përgjegjës për projektimin e arkitekturës së serverëve ku funksionon backend-i Java Spring Boot. Ai siguron shkallëzueshmëri, disponueshmëri të lartë dhe rikuperim në raste emergjence. Vendimet arkitekturore ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e sistemit. Certifikimi garanton kompetencë profesionale në dizajnimin e infrastrukturës kritike.

Punonjësi i certifikuar për storage ne nivel arkitekt ose ekuivalent, është i domosdoshëm pasi ky specialist projekton dhe menaxhon ruajtjen e të dhënave të sistemit, përfshirë backup dhe arkivim. Ai garanton sigurinë dhe integritetin e bazës së të dhënave PostgreSQL dhe skedarëve të sistemit. Vendimet për storage ndikojnë në performancën dhe qëndrueshmërinë e aplikacionit. Certifikimi siguron njohuri të avancuara për menaxhim profesional të hapësirës së ruajtjes.

Punonjësi i certifikuar si administrator sistemi për Sistemet Operative Microsoft Ëindoës Server, Linux ose Unix, ose ekuivalente, administron serverët Ëindoës, Linux ose Unix ku ekzekutohet sistemi. Ai kujdeset për sigurinë, përditësimet dhe monitorimin e shërbimeve. Funksionimi 24/7 i sistemit varet nga stabiliteti i sistemeve operative. Certifikimi garanton aftësi për menaxhim profesional të infrastrukturës kritike.

Specialist i certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter nivel profesional ose ekuivalent, ky specialist është i domosdoshëm pasi menaxhon mjedisin virtual ku janë instaluar serverët e sistemit. Ai siguron përdorim optimal të burimeve dhe rikuperim të shpejtë në raste dështimi. Virtualizimi është thelbësor për fleksibilitet dhe vazhdimësi shërbimi. Certifikimi nga prodhuesi garanton kompetencë teknike të verifikuar.

Punonjësi i certifikuar për baza të dhenash relacionale te tipit SQL ose ekuivalent, roli I tij është të administrojë bazën e të dhënave PostgreSQL ku ruhen të gjitha informacionet e sistemit. Ai siguron integritet, backup dhe rikuperim të të dhënave. Gabimet në databazë mund të shkaktojnë humbje informacioni kritik. Certifikimi garanton njohuri profesionale në menaxhimin e databazave relacionale

Punonjësi i certifikuar për optimizim të performances të bazës së të dhënave relacionale ose ekuivalent, ky specialist analizon dhe përmirëson shpejtësinë e ekzekutimit të query-ve. Ai optimizon indeksat dhe strukturën e databazës për ngarkesa të larta. Performanca e dobët ndikon drejtpërdrejt në punën e përdoruesve. Certifikimi garanton aftësi për optimizim profesional të sistemeve të dhënash.

Punonjësi i certifikuar për programim në ëeb në teknologji Java enterprise ose ekuivalente, ky punonjës shërben për të mirëmbajtur dhe përmirësuar backend-in e ndërtuar në Spring Boot. Ai korrigjon gabime, implementon funksionalitete të reja dhe siguron sigurinë e aplikacionit. Zhvillimi i gabuar mund të rrezikojë stabilitetin e sistemit. Certifikimi garanton kompetencë profesionale në zhvillimin e aplikacioneve enterprise.

Punonjësi i certifikuar për menaxhimin e proceseve të punës (business process management) ose ekuivalent, ky punonjës është i rëndësishëm pasi shërben për të analizuar dhe optimizuar proceset e punës që pasqyrohen në sistem. Ai siguron që rrjedhat funksionale të jenë të sakta dhe efikase. Sistemi duhet të përputhet me proceset reale të institucionit. Certifikimi garanton njohuri metodologjike për menaxhim profesional procesesh.

Punonjësi i certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje të ndërfaqeve përdoruesi (Frontend Ëeb Development) ose ekuivalent, është i domosdoshëm pasi shërben për të mirëmbajtur ndërfaqen e përdoruesit të ndërtuar në React. Ai përmirëson përdorshmërinë dhe korrigjon gabimet vizuale ose funksionale. Ndërfaqja është pika kryesore e kontaktit me përdoruesit. Certifikimi garanton aftësi profesionale në zhvillim frontend modern.

Punonjësi i certifikuar për implementim Server Aplikimesh (Application Server) ose ekuivalent, shërben për të konfiguruar dhe mirëmbajtur serverët aplikativë (Tomcat, Nginx, etj.). Ai siguron deploy korrekt dhe funksionim të qëndrueshëm të aplikacionit. Gabimet në server aplikativ shkaktojnë ndërprerje shërbimi. Certifikimi garanton kompetencë teknike në menaxhimin e serverëve aplikativë.

Punonjësi i certifikuar për softëare për analizë të dhënash BI (Business Intelligence) ose ekuivalent, është i rëndësishëm pasi shërben për të përpunuar dhe analizuar të dhënat e sistemit për raportim. Ai ndërton dashboard dhe statistika për menaxhimin. Analiza e të dhënave ndihmon në vendimmarrje strategjike. Certifikimi garanton aftësi profesionale në BI.

Punonjësi i certifikuar për menaxhimin e projekteve (PMP ose ekuivalente), ky punonjës shërben për të menaxhuar kontratën e mirëmbajtjes dhe koordinon ekipin teknik. Ai planifikon aktivitetet dhe menaxhon rreziqet. Respektimi i afateve dhe SLA varet nga ky rol. Certifikimi PMP garanton standard ndërkombëtar menaxhimi projektesh

Punonjësi i certifikuar në menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente), është i domosdoshëm pasi menaxhon shërbimet IT sipas praktikave më të mira. Ai administron incidentet, ndryshimet dhe problemet teknike. Qëllimi është rritja e cilësisë së shërbimit. Certifikimi ITIL garanton zbatim të standardeve ndërkombëtare.

Numri i punonjësve dhe kualifikimet e kërkuara janë përcaktuar bazuar në natyrën e shërbimit, duke u përputhur me specifikimet teknike, termat e referencës, objektin e prokurimit dhe proceset e punës që ky shërbim duhet të mbulojë.

III.4.2.3 Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.4.2.4. Në nenin 41, pikat 2 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me 24 nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me*

natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.4.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Advanced Business Solutions-ABS” SHPK për kundërshtimin e dokumentave të tenderit lidhur me kriterin e veçantë të kualifikimit pikës 2.3.3. si vijon: “... *unifikimin e kërkesës për formimin e arsimor për të gjithë stafin e specializuar të parashikuar në pikën 2.3.3 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. E thene me thjeshtë, ose të gjithë me Diplome Universitare ose të gjithë me Diplome apo kurse kualifikimi*”, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konkretisht shtojcës nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, konstaton, se kemi të bëjmë me një procedurë specifike dhe sensitive referuar objektit të prokurimit që është “shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në spitalin Rajonal Memorial Fier”. Për realizimin e procedurës objekt ankimi nevojitet një staf i specializuar për të cilin për të patur sigurinë për realizimin me sukses të objektit të procedurës autoriteti kontraktor ka kërkuar dorëzimin e diplomave/certifikatave sipas kategorive të caktuara, referuar profilit të secilit prej punonjësve. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes Komisioni konstaton, se operatori ekonomik nuk ka arritur të argumentojë se si kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e diplomave apo certifikatave cënon interesin e tij të ligjshëm dhe ngushton konkurrencën. Nga ana tjetër referuar procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, autoriteti kontraktor ka argumentuar nevojën për secilin nga specialistët për realizimin me sukses të kontratës. Akoma më tej Komisioni gjykon, se punonjësit e kërkuar si dhe kualifikimet e tyre janë përcaktuar bazuar në natyrën e shërbimit, duke u përputhur me specifikimet teknike, termat e referencës, objektin e prokurimit dhe proceset e punës që do të kryejë secili. Referuar natyrës së punës që do të kryejë secili prej punonjësve për punonjësit në pikën b, c, d, f, g, h, i, j për shkak të natyrës së punës Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e diplomës i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për

realizimin e synimit, pasi nisur nga detyrat që do të kryejnë është e nevojshme që të zotërojnë njohuri më të thelluara të cilat mund të vërtetohen përmes paraqitjes së diplomës përkatëse, pasi janë njohuri që nuk mund të fitohen nëpërmjet trajnimeve. Pra paraqitja e diplomës universitare është proporcionale me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. KPP gjykon, se ky kriter është i përshtatshëm për arritjen e synimit të kërkuar dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin duke përmbushur në këtë mënyrë edhe testin e proporcionalitetit në lidhje me hartimin e tij. Komisioni gjykon, se formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/diplomë sipas kategorive dhe shërbimeve që do të kryejë secili nga punonjësit. Akoma më tej referuar shkresës me nr. 283/7 prot., datë 04.02.2026 autoriteti kontraktor ka argumentuar teknikisht kërkesën e tij për dorëzimin e diplomës apo certifikatës sipas kategorisë për secilin nga punonjësit, ndërsa referuar ankesës me nr. 293 prot., date 30.01.2026 operatorit ekonomik nuk ka argumentuar se si ky kriter cënon interesin e tij të ligjshëm dhe cënon konkurrencën. **Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-74198-01-20-2026, me objekt: “Shërbim mirëmbajtje i platformës së integruar dhe të shkallëzueshme të sistemit të dixhitalizimit në Spitalin Rajonal Memorial Fier”, me fond limit 30,000,000 (Tridhjetë milion) lekë, pa TVSH, ose 310,784.21 (Treqind e dhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër pik njëzet

e një) Euro **pa TVSH**, parashikuar për t'u zhvilluar në datë 20-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Advanced Business Solutions - ABS" SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës dhe Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik "Advanced Business Solutions - ABS" SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

